



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 58, datë 20.04.2021

PËR
MIRATIMIN E FONDIT PREJ 300.000 (TREQIND MIJË) LEKË PËR RIMBURSIMIN
E SHPENZIMEVE PËR NDËRHYRJET KIRURGJIKALE DHE PËR RIKUPERIMIN
FIZIK POST TRAUMË TË VOLEJBOLLISTES PAMELA MEHJA, PJESË E
SKUADRËS SË VOLEJBOLLIT PËR FEMRA “TEUTA”, DURRËS

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.79/2017 “Për Sportin”, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023” dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e fondit prej 300.000 (treqind mijë) lekë për rimbursimin e shpenzimeve për ndërhyrjet kirurgjike dhe për rikuperimin fizik post traumë të volejbollistes Pamela Mehja, pjesë e skuadrës së volejbollit për femra “Teuta” Durrës.
2. Ky fond do të merret nga fondi rezervë për vitin 2021, miratuar me VKB-në Nr. 123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 20.04.2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 292/prot.
15

Durrës, më 21.04.2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 58 datë 20.04.2021 “Për miratimin e fondit prej 300.000 (treqind mijë) lekë për rimbursimin e shpenzimeve për ndërhyrjet kirurgjikale dhe për rikuperimin fizik post traumë të volejbollistes Pamela Mehja, pjesë e skuadrës së volejbollit për femra “Teuta”, Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

